



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 468/ Prot.

Tiranë, më 07.03.2025

**VENDIM**

Nr. 15 Datë 07.03. 2025

**“PËR  
MIRATIMIN E BURSIVE TË STUDENTËVE DHE PËRJASHTIMIN NGA  
TARIFA E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË QË  
PLOTËSOJNË KRITERET, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 NË  
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të VKM nr. 903, dt. 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, me VKM nr. 39 datë 23.01.2019, VKM 269 datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të integruar të studimeve... që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar me VKM nr. 40 datë 23.01.2019, në Vendimin Nr. 32 datë 07.08.2024 "Për miratimin e tarifave të regjistrimit për konkurs, regjistrimit të fituesve, për ciklin e parë dhe të dytë, të tretë të studimeve dhe tarifave të shkollimit për të 3 ciklet e studimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin Nr. 41 datë 31.10.2024 "Për Miratimin e formularëve për përfitim burse, përjashtim nga tarifa shkollimit për ciklin e parë të studimeve, reduktim 50% nga tarifa e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin e Sporteve të Tiranës", si dhe në Relacionin e Komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit me nr. 621 prot, datë 20.02.2025 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për aplikimet për bursë dhe përjashtim nga tarifa e studimit për ciklin e parë të studimeve",  
Bordi i Administrimit ,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës së studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përfituar bursë, dhe për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, sipas kriterëve të detajuar, Kriteri 1, tabela bashkëngjitur;
2. Miratimin e listës së studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për tu

përfunduar nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025, sipas kriterëve të detajuar, Kriteri 14, tabela bashkëngjitur;

3. Efektet financiare për studentët që kanë aplikuar brenda afateve të përcaktuara fillojnë nga fillimi i vitit akademik 2024-2025, dhe studentët që kanë aplikuar pas afatit 15.12.2024 llogariten sipas datës së aplikimit.
4. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë dhe me efektet financiare duhet të dërgohet në MAS dhe AKFAL.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur ÇOBANI**



**Kriteri nr.1: Studentët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike**

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakul.	Viti	Efekti Financiar i perjashtimit	Efekti Financiar i Burses
1	EF813A120180	I. K.	3300/36	18.11.2024	FVFR	2	17,500	90,000
2	EF813A110017	R. M.	3706/9	05.12.2024	FVFR	3	17,500	90,000
3	EF813A110059	A. Rr.	3781/3	12.12.204	FSHR	3	35,000	90,000
4	EF813A120379	Xh. D.	338	28.01.2025	FSHR	2	17,500	51,818
<b>Totali</b>							<b>87,500</b>	<b>321,818</b>

**Kriteri nr. 14: Studentët të cilët kanë të paktën njërin prind person me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me KMCAP, përfitues i pagesës së aftësisë të kufizuar**

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakul.	Viti	Efekti Financiar i perjashtimit	Efekti Financiar i Burses
1		K. L.	369/2	30.01.2025	FVFR	3	35,000	0
2		G. P.	539	12.02.2025	FVFR	3	35,000	0
<b>Totali</b>							<b>70,000</b>	<b>0</b>

**Eduard Meçaj**